



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 28.10. 2015**

**TETOR
2015**

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Kryetar i Komisionit z. Muhamet Mustafa

KRYETARI: Mirëmëngjesi të gjithëve,

Më lejoni që në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të hap dëgjimin publik lidhur me Projektligjin numër 05/L-057 themelimi i fondit kosovar për garanci kreditore. Ju falënderoj për pjesëmarrje, ju përsënderes gjithë përfaqësuesit e shoqatës së bankave, përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe akter tjerë të interesuar lidhur me këtë ligj, përfaqësuesit e kontraktorit të USAID-it që japin asistencë lidhur me këtë ligj dhe gjithë pjesëmarrësit tjerë, po ashtu i falënderoj edhe kolegët tjerë të komisionit që kanë ardhur të dëgjojnë mendimet e akterëve të interesuar për këtë ligj të rëndësishëm.

Pasi Qeveria ka dërguar këtë projektligj në Kuvend, ne kemi debatuar në Komision dhe kemi aprovuar në parim projektligjin i cili është aprovuar edhe në një seancë të Kuvendit të cilin për herë të parë jemi ballafaquar edhe me gazin lotsjellës por përkundër kësaj pjesa më e madhe e Kuvendit e kanë krye punën, e kanë aprovua ligjin që do të shkoj në debat të mëtejshëm. Ne kemi konsideruar të nevojshme që të bëjmë një dëgjim publik para se të amendamentojmë ligjin, ne i presim amendamentet pra në vijim edhe 2-3 ditë dhe pas kësaj bisede ne do të fillojmë në grupin punues ku jem unë edhe deputeti Beqaj edhe deputetja që do t'i merr në konsiderim do t'i propozoj amendamentet komisionit dhe brenda një periudhe optimale do ta rikthej këtë ligj në Kuvend për të aprovuar definitivisht. Natyrisht, se ne kemi konsideruar këtë projektligj shumë të rëndësishëm, për faktin se komplet, është komplementar me një pako masash të cilat do të nxisin aktivitetin investues në Kosovë.

Kjo është i një rëndësie të madhe sepse Kosova investon pak diku rreth 20% të GDP duke marrë parasysh përpjesëtimet që i ka në konfiguracionin makro ekonomik veçanërisht lidhur me bilancin tretar po edhe me problemet e punësimit dhe nivelin e zhvillimit të Kosovës si një vend me të ardhura mesatare pra në grupin e vendeve me të ardhura mesatare të ulëta.

Kosovës i duhen shumë më shumë investime për të adresua punësimin. Kjo përqindje e investimeve të GDP-së duhet të shkoj mbi 25 e ndoshta në rastin e Kosovës duhet të jetë diku 30%, në mënyrë që ne të gjenerojmë vendet e punës diku që janë projektua prej partive në pushtet dhe koalicionit por në programin qeveritarë edhe pse atje nuk janë dhënë kvantifikime por diku është një minimum që ne në vjet duhet të arrijmë të gjenerojmë 25 mijë vende të punës dhe duke marrë parasysh që 5 mijë shkojnë në pension krijohen 30 mijë vende të punës dhe në atë mënyrë dhe aftësohemi që të absorbojmë kontingjente të reja në tregun e punës dhe plus të fillojmë ta zvogëlojmë dalë nga dalë papunësinë. Në këtë drejtim pra nevojitet që të veprojmë në shumë pika, në shumë fronte që të nxisim aktivitetin investues veçmas të sektorit privat.

Pra gjenerimi, investimi nga sektori privat është një çështje kyçe për Kosovën për arsye se Kosova nuk ka më hapësirë buxhetore që të rritë investimet publike e ka mëri maksimumin domethënë me rritjen e investimeve publike dhe ... vendet e punës dhe gjenerimi i rritjes ekonomike nuk mund të bazohet aq shumë sa është bazua në 4-5 vjetët e fundit apo 6-7 vjetët e fundit në investime publike.

Prandaj, nxitja e investimeve private, vendore dhe të jashtme është me rëndësi kruciale për Kosovën. Në këtë drejtim komisioni ka vlerësua të rëndësishëm këtë projektligj për arsye se është i rëndësishëm sidomos për ... për bizneset që nisin dhe për ato që kanë probleme të sigurojnë një pjesëmarrje apo një hipotekë për kredi të tyre.

Gjithashtu, ne kemi vlerësuar të rëndësishme që t'i diskutojmë edhe disa çështje lidhur me bankat, lidhur me legjibilitetin e bankave, lidhur me tarifat që do të duhej të gjenerojë ky fond për të financuar aktivitetet e veta si dhe lidhur me natyrën aksionarë apo dividendave që eventualisht mund të gjenerohen në këtë fond.

Këto kanë qenë 2-3 brenga në Komision që i kemi lënë që t'i trajtojmë në debat publik dhe në këtë dëgjim publik.

Gjithashtu ne kemi marrë një material, kemi marrë disa propozime nga insituti GEP lidhur me vrojtimet e tyre, lidhur me këtë ligj. Unë besoj që sot zoti Demi do të na prezantoj këtu dhe akter tjerë jeni të ftuar që pra t'i japni propozimet e juaja se çka konsideroni se duhet të përmirësohet ky projektligj dhe mandej ne në bashkëpunim me ju por edhe në bashkëpunim me konsultat tanë të brendshëm dhe të jashtëm veçmas nga USAID-i do të bëjmë amendamentimin e këtij ligji.

Unë për fillim propozoj që të dëgjojmë një hyrje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, mandej do ta keni fjalën ju.

Ne deputetët sot më shumë do të dëgjojmë mendimet e juaja por sigurisht edhe deputetët do të inkuadrohen me komentet e juaja ose me një pyetje për të sqaruar propozimet e juaja. Faleminderit! Urdhëroni!

REMZIJE HAJDARI:

Remzije Hajdari, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti ligjor.

Faleminderit, kryetar! Edhe pse ju në pika të shkurtra treguat qëllimin e këtij projektligji, mirëpo prapë si bartës i këtij projektligji unë dua me e cekë arsyen pse ka ardhur deri te propozimi i këtij projektligji. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është procedimi i përsheptuar i pakos legjislative dhe formës administrative në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit.

Qëllimi i këtij projektligji është që të rritet mundësia e financimit për kategori të caktuara të bizneseve që e kanë pasur të vështirë të marrin financim nga bankat. Këtu e kam fjalën në radhë të parë për bizneset e grave, fermerëve, prodhuesve vendor, të ndërmarrësve që dëshirojnë të fillojnë një biznes apo të zgjerojnë një biznes ekzistues. Fondi do të mbuloj deri në 50% të ... dhe kjo do të bëjë bankat më komode në aprovimin e kredive për bizneset të cilat e kanë të pamundur garantimin e kërkesave kreditore me asetet vetanake.

Kjo përbindje mund të rishikohet pas një periudhe të caktuar kohore varësisht nga gjendja financiare e fondit. Por fillimisht është menduar që të jetë në këtë nivel në mënyrë që të ofrohen sa më shumë garancione dhe të lehtësojnë më shumë kredi nga bankat. Me gjithë se qëllimi kryesor i fondit nuk është që të ulë normat e interesit. Ne besojmë që institucionet bankare dhe

jobankare si dhe ato mikro-financiare do të reflektojnë edhe në këtë aspekt duke i bërë ofertat e tyre për bizneset më të favorshme se ato ekzistuese.

Si do që të qoftë ne jemi të vetëdijshëm që banka duhet të paguaj një kosto shtesë për shërbimet garantuese të fondit. Fondi kosovar për garanci kreditore do të jetë një institucion i pavarur autonom i cili do të funksionoj në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës, do të ketë përgjegjësinë e plotë në bazë të ligjit për qeverisje korporatave, kontabilitetit, auditimin dhe raportimin. Dhe në këtë aspekt ai është shumë analog me fondin për sigurimin e depozitave.

Ka pasur edhe ide që fondi të bëhet në partneritetin me sektorin privat por në përjashtim të një banke vendore të tjerat nuk kanë treguar interesim. Pjesëmarrja e kapitalit privat në .. sidomos nga sektori bankar do të mund të gjeneronte konflikt interesi në menaxhimin e tij. Kështu që në formatin e tanishëm me mbikëqyrjen rigoroze nga Banka Qendrore e Kosovës besoj që fondi do të arrijë të ruaj pavarësinë operationale dhe të menaxhoj me kujdes portofolin e tij.

Një arsye tjetër për prioritetin e lartë për themelimin e Fondit Kosovar për garanci kreditore është fakti se donatorët ndërkombëtarë janë zotuar se do të japim 20 milionë dollar amerikanë, 18 milionë euro si asistencë teknike për të zhvilluar dhe implementuar fondin kosovar për garanci kreditore, si dhe për të financuar kapitalin për të mbështetur garanci. Është esenciale që fondi të themelohet sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që të kapitalizohen fondet në fjalë dhe të arrihet një rritje ekonomike dhe punësim.

Në rast të themelimit të Fondit ... edhe nuk do të ndodhte brenda vitit 2015, fondet e donatorëve mund të mos jenë më në dispozicion. Fondi llogaritet që diku në gjashtë vitet e para do të rrisë mundësinë për kredi të reja në rreth 36 milionë euro dhe pritet që nga huat e reja të mund të krijohen deri në 20 mijë vende të reja pune.

Raporti i progresit nga Komisioni Evropian për Kosovën i vitit 2014, gjithashtu thekson që qasja e kufizuar në financa është një prej sfidave kryesore të zhvillimit të ..-ve dhe rritjes së mëtutjeshme. Ndërsa në raportin e Bankës BotëroreKosova ka rëndë tek indikator i marrjes së kredive nga vendi 19 në vitin 2014, në 23 në vitin 2015.

Dhe është e qartë se Kosova ka nevojë që urgjentisht të përmirësoj qasjen në ndërmarrje të vogla dhe të mesme në financa. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe i ka zhvilluar konsultimet me publikun paraprake.

Kjo është një arsyetim i shkurtër sepse në këtë rast unë jam që të mbroj ligjin si ligj, t'i sqaroj procedurat. Ndërsa në aspektin teknik është eksperti i USAID-it i cili edhe e ka hartua planin e biznesit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozoj që të dëgjojmë menjëherë edhe absorbimet të institutit GAP.

AGRON DEMI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje të gjithëve,

Ne nuk ka një muaj që kemi pasur një diskutim publik edhe me ministren e Tregtisë dhe Industrisë ku parimisht e kemi mbështetë një iniciativë të tillë. I kuptojmë arsyet për çka është ... një ligj i tillë dhe siç e përmenda janë arsyeime që kanë bazë, për shkak se bankat kanë krijuar një shumë të madhe të parave në depozita të cilat do të duhej që të përfshiheshin në zhvillimin ekonomik dhe pa një garancinë të tillë është e pamundur duke marr për bazë informalitetin e lartë edhe sidomos funksionimin e sistemit gjyqësorë në Kosovë.

Ne në raportin që ju e përmendët e kemi bërë edhe një krahasim me vendet e tjera të cilat kanë një fond të tillë e ku diku më shumë e diku më pak ka pasur sukses fondi për garanci kreditore. Ne kemi krahasuar edhe me një fond aktual i cili është vetëm fuqi në Kosovë, aktiviteti për zhvillim kreditor i cili nëse e shikojmë impaktin e tij nuk ka qenë ashtu siç është shpresua në fillim. Po është edhe tash aktual duke u implemtua autoriteti për zhvillim kreditor i cili ndihmon bizneset në fushën e bujqësisë dhe i cili fillimisht është paraparë që do të ulë normat e kredive deri diku në 10% por në fakt nuk ka ndodh ashtu.

Nuk ka pasur një ndikim shumë të madh pozitiv ashtu siç është shpresua. Prandaj edhe ne jem skeptik se të gjitha këto synimet me ligjin e ri për garanci kreditore do të arrihen ne i mbështesim që të provohet për shkak të një prej problemeve më të mëdha që kanë bizneset e reja dhe ato të vogla është edhe qasja në kredi, kështu që bankat nuk u besojnë bizneseve të reja edhe bizneseve të vogla që tu japin kredi pa pas një rekord apo një historik të funksionimit të suksesshëm edhe pa u ofruar dëshmi për kolateralin e që këto bizneset e reja nuk i kanë.

Andaj, shpresojmë që me ligjin e ri këto probleme do të evitohen. Siç e pamë edhe dje në raportin e ri të Bankës Botërore të të bërit biznes nuk është që Kosova ka përparuar shumë, qato 7 vende që kanë përparuar është diçka që nuk janë varur nga ne por janë varur se vendet e rajonit kanë përformuar shumë më keq se sa Kosova përgjatë një viti, por ende... ata kanë ngel mbrapa kështu që na kanë mundësuar neve me dal pak më mirë, por prapë mbetet shqetësuese që implementimi i kontratave apo në aspektin e implementimit të kontratave Kosova mbetet në vendin e 138 këtu nuk është shumë faj i Qeverisë, por është faj i sistemit gjyqësor ku kryetar është dashur me ndryshu diçka.

Andaj, duke marrë krejt këto parasysh shpresojmë se fondi ka me ndiku pozitivisht. Ne kemi dhënë disa rekomandime të cilat i kemi dërguar edhe tek partnerët e ministrisë, të cilët kanë ndikuar që të ndikojnë në bërjen e draftit por po i lexoj shkurtimisht edhe në këtë takim, megjithëse i kemi edhe të gjitha në email.

Ajo që kemi rekomanduar është që Ligji për fondin për Kosova për Garanci Kreditore të përcaktojë përqindjen e mbulushmërisë, si dhe tarifave nga përfituesit e fondit, të rishikohet mundësia e e ristrukturimit të fondit që të bëhet i përzier me kontribut të Qeverisë, donatorët e jashtëm edhe bankave komerciale, Ligji për fondin për garanci kreditore të qartësojë protokollin e komunikimit mes Bankës Qendrore, Fondit edhe Ministrisë së Tregtisë dhe akterëve tjerë. Për shkak se aktualisht në ligj nuk ka një protokoll tjetër të komunikimit qartë, të punohet paraprakisht dhe paralelisht në forcimin e sistemit ligjor, sidomos në sektorin që merret me mbledhjen e borxheve, të punohet paraprakisht dhe paralelisht në uljen e informalitetit tek bizneset dhe e fundit të rregullohet me ligj çështja e kolateralit që mund të kërkohet prej klientëve nga ana e bankave.

Ne jemi të gatshëm që edhe në kuadër të grupeve punuese këto rekomandime tona të punojmë bashkë me ju që të jemi pjesë e draftit final të ligjit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Nga USAID-i, Haxhi Gashi është paraqitur.

HAHXI GASHI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Përshëndetje për deputetët dhe gjithë përfaqësuesit,

Unë ju e thatë në ... edhe për qëllimin, u tha edhe nga Ministria dhe nuk kisha dashur shumë por ne gjithmonë kemi diskutuar në komisione edhe në legjislatura tjera si do të ketë ndërmarrjet qasje më shumë në kapital të bankave të cilat nuk kanë kapital kur ai nuk është paraqitur në treg. Dhe kështu që ishte njëra prej strategjive edhe të ministrisë, por edhe të USAID-it që për ta formuar një fond të tillë.

Edhe mendoj që arsyeja pse është ... me një fond të natyrës publike se ka pas alternativa të ketë një edhe ndërmarrjet private që të kenë forma tjera pikërisht se duhet të adresohet çështja e ndihmës shtetërore, në qoftë se shteti derdh buxhet ose donatorët në një ndërmarrje private, atëherë kjo. Por, megjithatë ne këtu e kemi ekspertin që do të sqarojë më shumë për çështjet e fondit Michael Gold i cili do të jap prizmin e fondit nga prizmi profesional dhe nga projekti i USAID-it për fuqizimin e kredive.

NJOMZA ZEJNULLAHU: Zoti kryetar, për ata që s'njihemi Njomza Zejnullahu këshilltare ligjore ligjore në projektin e USAID-it.

Meqenëse nuk kemi përkthim simultan anglisht-shqip vetëm për serbisht, ose mundem edhe këtu nëse jeni këtu ok. S'ka nevojë për përkthim, ok! S'kam bërë kurrë punën e përkthyesit kështu që më lehtë e bëj këtu.

MICHAEL GOLD: (Transkripti i shkruar nga simultanti)

Nëse nuk është prezantuar është Michael Gold nga projekti i USAID-it njëri prej udhëheqësve teknik pjesës teknike të projektit.

Po i falënderon të gjithëve për mundësinë për me mbajt një takim të tillë edhe me i shpreh opinionet lidhur me Fondin për Garanci Kreditore.

Michael është në Kosovë që nga viti 2000, përveç kësaj udhëheq edhe një fond, udhëheq edhe një institucion financiar jo bankar të licencuar nga banka Qendrore, prandaj e ka eksperiencën e dorës së parë në aktivitetet financiare në Kosovë, por edhe më gjerë. Fondi "Krimstin Katel" të cilin ai e udhëheq për disa vite në Kosovë 15 vite tash, fokusohet në dhënien e kredive të kategorive, të cilat kanë probleme me qasjen që janë bizneset e reja, bizneset në pronësi të grave edhe bizneset më të vogla, ndërmarrjet më të vogla dhe të mesme.

Me këtë pjesëmarrje jam më se i vetëdijshëm për ambientin e të bërit biznes në Kosovë dhe rregullativën financiare, të sektorit financiar dhe me çështjet që kanë të bëjnë me kontratat, zbatimin e kontratave të kredive. Në raportin e Bankës Botërore i cili u publikua dhe ne kemi mundur të rankohemi më lartë megjithatë janë disa gjëra të mira aty që reflektohen. Por, ajo që është më e rëndësishmja është pjesa praktike ajo që ndodh çdo ditë në praktikë.

Në çështjen e zbatimit të kontratave tashmë e kemi në vend dhe aplikohen përmbaruesit privat që në një masë të madhe e kanë lehtësuar procesin e zbatimit të kontratave të kredive dhe kjo është pritur shumë mirë nga bankat dhe institucionet tjera financiare dhe është një hap shumë i madh përpara në proces. Disa amendamente priten dhe janë të mirëseardhura në Ligjin për procedurën përmbarimore megjithatë Ministria e Tregtisë është duke e marrë, është në proces amendamentimi i këtij ligji gjë që e lehtëson shumë procesin.

Fondi për garanci kreditore në bazë të këtij, të kësaj që u tha deri më tash është ideja është ndërtuar si e tillë në bazë të analizave paraprake, hulumtimeve dhe të gjitha fondeve tjera, praktikave të ngjashme në vendet tjera. Kemi punuar ngushtë me ekspertët më të mirë ndërkombëtar, përveç asaj edhe me Bankën Qendrore, institucionet tjera përkatëse që ta bëjmë një fond që vërtetë funksionon. Llojet e garancive që do të vendosen në kuadër të këtij fondi për garanci kreditore janë marrë sipas modelit të një programi një skemë ekzistuese që e ka USAID-i ... programi që deri tash është paraqitur shumë i suksesshëm. Deri tash 6 banka komerciale në Kosovë kanë marrë pjesë në këtë programin paraprak të USAID-it edhe e kanë rritur në mënyrë enorme kredi dhënien.

Dhe ajo çka e tregon suksesin e programit është edhe fakti që kreditë e këqija kanë qenë në një përqindje shumë të ultë. Qëllimi i Fondit për Garanci Kreditore është që të ndërtojë një skemë të tillë të qëndrueshme permanente në Kosovë dhe të vazhdueshme që gjatë gjithë viteve të ofrojë qasjen në financa për ato biznese që nuk mund të kenë qasje në financa në rrethana tjera.

Edhe pajtohemi që janë esenciale për Kosovën, por edhe për bizneset përcaktimi dhe shfrytëzimi i duhur i provizioneve dhe tarifave që do të gjenerojë ky fond. Sa i përket provizioneve dhe tarifave, ato do të ndërtohen në formë, do të thotë koncepti do të ndërtohet në atë formë që vetëm sa do të mjaftojë për të mbuluar shpenzimet operationale të fondit edhe qëndrueshmërinë e fondit. Meqenëse do të jetë një institucion permanent edhe i vazhdueshëm është esenciale që të jetë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet e veta.

Do të thotë fondi do përcaktojë këto tarifa vetëm me qëllimi me i mbulu shpenzimet e veta operative dhe eventualisht të mbulojë humbjet përkatëse në kreditë e garantuara dhe janë ndërtuar mekanizma mbrojtës për tu siguruar që kjo do të aplikohet. Çdo para e fondit mbetet në fond. Do të thotë, shkurt nuk do të ketë dividend asnjë fitim i fondit qoftë edhe nëse kalon shpenzimet kapacitetin për të paguar shpenzimet operationale tepër e fondit do të mbetet në fond, do të thotë asgjë nga fondi nuk kalon dhe nuk shpërndahet asnjë dividendë në asnjë formë tjetër.

Ndërkohë, që tarifat do të specifikohen vetëm atë sa për të mbuluar shpenzimet. Sa i përket përqindjes së garancisë e cila u ngrit si çështje edhe nga përfaqësuesi i institutit GAP do të jetë

dhe është specifikuar në ligj, dhe do të jetë deri në 50% por kjo s' do të thotë që mund të mos jetë më pak, ideja është domethënë prej 1 deri në 50%.

Arsyeja pse është përcaktuar të jetë 50% është ideja që bankat të inkurajohen që të lëshojnë kredi të mira në kuptimin që ta kenë kujdesin e duhur njësoj sikur kur e lëshojnë kredinë pa garancinë e fondit edhe rrjedhimisht kredia të mos del pas një kohe shumë të shkurtë në vonesë.

Edhe praktika e ka treguar që është shumë më mirë me qenë e limituar përveç tjerash nëse na lejojnë më pak se 50% atëherë e mundëson fondin që më shumë me fut kredi në garanci, sa më e ultë përqindja aq më shumë ka mundësi me u garantuar kreditë. Sa i përket ndikimit impakti që do të ketë fondi kjo sigurisht do të varet në proces prej numrit të kredive që do të lëshohen, paratë që do të gjenerohen në atë proces e tjera, e tjera. Megjithatë, deri tash kemi zotim prej bankave komerciale që ata do t'i shfrytëzojnë mjetet që i kanë për të dhënë sa më shumë kredi në këtë rast.

Disa nga bankat i kanë paratë tona, në bankat të huaja ku marrin interes, kamat negative. Edhe është në interesin edhe të bankave edhe të gjithëve që sa më shumë para të lëshohen, do të thotë të jepen në formë të kredisë do të ketë beneficione për bankat dhe për individët, si dhe për vendin në tërësi. Faleminderit të gjithëve, të gjithë atyre që kanë ndihmuar me e kriju këtë fond edhe me më ndihmu në lirimin e atyre mjeteve që janë të pashfrytëzueshme për momentin nga bankat dhe me e mundësu sa më shumë kredi dhënie që rrjedhimisht do të ndikojë në ekonominë e vendit.

(Anglisht.).... Është gatishmëria e deritashme e të gjithëve për të ndihmuar në këtë proces dhe pjesa më e mirë është që ne e kemi tashmë praktikën e programit paraprak të USAID-it, ku bankat kanë bashkëpunuar ngushtë me këtë proces dhe është shfaqur si i suksesshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti Gold! Unë mendoj se kjo e sqaroi kontekstin dhe pritjet nga ky fond. Edhe ne ju falënderojmë për përdorimin e eksperiencave tuaja të gjëra edhe me ekonominë e Kosovës, por edhe me përvojat e punës së USAID-it edhe në vendet tjera.

Ajo që dëshiroj unë të theksoj, është diçka që edhe zoti përfaqësuesi i GAP-it Agoni e përmendi, sepse fondi do të jetë i suksesshëm për aq sa mbështetet me institucionet tjera jashtë fondit. Domethënë, nëse ne mendojmë se vetëm fondi do t'i zgjidhë problemet e mbesim me të njëjtin problem të zgjidhjes së kontesteve biznesore dhe pritjes së bizneseve me vite, mendoj se efektet nuk do të jenë të mira.

Gjithashtu, nëse mjedisi biznesor nuk përparon efektet e fondit do të jenë, por do të jenë të limituara. Dhe, unë mendoj se përvojat, nëse i analizojmë me kujdes përvojat botërore me këto fonde, ato tregojnë se fondet kanë qenë të suksesshme, nëse kanë qenë pjesë përbërëse e një sistemi integral të masave për përmirësimin e klimës së biznesit dhe për një mjedis të favorshëm për investime. Edhe me të drejtë sot u përmend këtu çështja e zbatimit të kontratave.

Ne kemi debatuar dy herë në këtë komision problemin e stërzgjatje së kontesteve biznesore. Nuk po shohim shumë shqetësime të institucionit që duhet ta adresojnë këtë çështje, e kemi dërguar edhe në Këshillin Nacional të Zhvillimit këtë çështje që të trajtohet. Përndryshe, ne duhet të

bëjmë çmos që kontesteve biznesore tu reduktohet zgjatja e adresimit të tyre nga disa vite në disa muaj. Përndryshe, do të mbesim në vendin e 138 në zbatim të kontratave, që është një çështje shumë brengosëse.

Dhe, kjo do të thotë që na duhen masa shumë... dhe, mendoj se me përpjekje serioze mund të ndryshohet kjo situatë. Unë kam përshtypjen se ne kemi krijuar një, të them ashtu, sistem gjyqësor që është i pavarur nga ekzekutivi edhe nga legjislativi, gjë që është mirë. Mirëpo, ajo pavarësi është kuptuar si një autonomi e plotë dhe unë nuk mërzitem çka ndodhë në shoqëri. Mendoj, se këtu kemi një keqkuptim.

Edhe sistemi gjyqësor duhet të japi një përgjegjësi dhe llogaridhënie dhe nëse Këshilli Gjyqësor nuk është në gjendje me e bë këtë, atëherë duhet të trajtojmë rolin e Këshillit Gjyqësor apo të drejtojmë mekanizma, në të cilin edhe gjyqësori do të japë llogaridhënie. Faleminderit! Deputeti Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Përfaqësues të ministrisë,

Të gjithë të pranishëm,

Ne në parim e kemi përkrahur si ligj të nevojshëm, i cili do ta ndihmojë financimin dhe do ta lehtësojë financimin, qasjen në financa për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, por besoj që si ligj që është shumë senzitiv dhe shumë i nevojshëm, së paku nga përvoja ime, e kam thënë edhe në mbledhjen e grupit kur e kemi pasur, është shumë i pa specifikuar.

Nëse e marrim ligjin, ne i kemi vetëm nja 7, 8 nene, që flasin për garancitë kreditore, pjesa tjetër janë procedura administrative, të cilat parimisht janë të njohura. Këtu besoj që është shqetësimi kryesor. Ligji nuk guxon të bëhet ligj i cili kuptohet në kontekst. Ne këtë që na u tha sot, është e kuptueshme në kontekst, por nëse e lexojmë ligjin nuk kuptohet. Pra, as nuk kuptohet për dividendë, as nuk kuptohen qartë burimet e financimit, as nuk kuptohen qartë tarifat qysh rregullohen, as nuk kuptohet qartë se cilat janë kriteret për dhënie të kreditimit, as për përcaktim të tarifave. Pra, flasim për një ligj i cili është shumë i gjerë. Nëse nisemi me radhë prej nenit 5, pika 1 thotë: “Fondi mund të lëshojë garanci kreditore apo instrumente të tjera financiare....” . Cilat janë instrumentet financiare tjera?

Duhet ta kuptojmë! Nuk jemi këtu duke bërë listë dëshirash, sepse nëse flasim për instrumente të tjera financiare, nëse këtu s’janë të shpjeguara, duhet të shpjegohen diku më vonë në ligj. Cilat janë mundësitë? Ne po ia lëmë këtij fondi një mundësi “deti” të madhe, që këta të bëjnë çka të duan, çfarëdo instrumentesh të duan me bë si të tilla. Dhe për më shumë, në disa raste konsiderohet se ligji mund t’i mbizotërojë ligjet tjera financiare, që sërish nuk është në harmoni me rregullat ligjore, të cilat ne i kemi në vendin tonë.

Neni 8 është i paraparë me i rregullua tarifat dhe provizionet. Nuk shpjegon as mënyrën se si përcaktohen tarifat, as provizionimin, do të thotë edhe as shpërndarja e tyre. Kush e përcakton tarifën? E përcakton bordi. Nëse shkoni më tutje në ligj shihni që bordi caktohet, një është Ministria e Financave, një Ministria e Tregtisë ex-officio, lejon katër përfaqësues nga donatorët dhe po i quajmë njëfarë institucioni të pavarur.

U përmend këtu edhe fondi për sigurimin e depozitave, që u përmend si sinonim. Nuk është ky fond me fondin për sigurimin e depozitave nuk është sinonim, sepse fondi për sigurimin e depozitave ka tjetër sistem, ky ka kreditim. Pra, mos ti përziejme gjërat në kuptimin e operimit.

Ka nevojë të qartësohet, se cilat janë format e caktimit të tarifës dhe, jo ta lëmë që të nënkuptohet. Nëse shkoni në themelim, në nenin 10, pika 5, që prapë shpjegon se si funksionon, pra themelimi dhe forma e FKGGK-së, unë nuk e kuptoj si titull, se çka është ky nen!

“Themelimi dhe forma”, çfarë forme, a është forma e funksionimit, a është forma e zbatimit, a është e kreditimit... pra, si titull është i paqartë, nuk shpjegon.

Në pjesën 2, thotë “...pa kufizime për veprimet e ardhshme.”. Pra, ka defekte serioze në kuptimin legjislativ, si ligj i tillë.

Neni 5 thotë, çdo e hyrë pranon nga tarifat kthimin e investimit, donacionet dhe pastaj e shpjegon dhe, në rast të mospërputhjeve me ligjet tjera në fuqi, ky ligj mbizotëron. Me cilat ligje në fuqi? Ne duhet ta dimë, që ka ligje të tjera, të cilat e mbizotërojnë këtë ligj.

Nëse shkojmë tek burimet e financimit është neni 11, autorizimet pra të këtij, pika 1.1 thotë: “... është kapitali themelues, që jep institucioni, që është minimali 300.000...”, pastaj janë tarifat, interesi, kontributet tjera kapitale, huamarrje dhe të hyra të tjera, të përfituara ligjërisht.

Thënë të drejtën, unë nuk jam jurist, por nga përvoja po them që asnjë ligj nuk parasheh të hyrat të cilat janë joligjore në një institucion dhe, nuk ka nevojë të thuhet si e tillë.

Te Bordi menaxhues, sepse prej nenit 15 e tutje flet vetëm për procedura. Do të thotë, prej nenit 5 deri në nenin 15 flitet për disa procedura të funksionimit, pjesa tjetër është komplet pjesë qeverisëse, pra e cila rregullon funksionimin. Thotë: “Bordi menaxhues merr vendim...”, është neni 17, pika 1.10, “... merr vendim për përcaktimin e tarifave sipas dispozitave të këtij ligji...”.

Unë nuk po shoh që ka dispozita, mbi çfarë baze merr vendime për tarifa. Cila është baza për marrjen e vendimeve për tarifat? Cilat janë kriteret? Thotë sipas dispozitave të ligjeve, por nuk po shoh kurrfarë dispozite e cila shpjegon një procedurë të tillë.

Pra, jemi në... unë i kam thënë dhe do t’i them këto edhe në grup punues, besoj që si ligj është shumë i nevojshëm. Sektori privat ka nevojë, nuk duhet ta konsiderojmë që kjo është shpëtimi i Kosovës, në kuptimin e financimit, sepse do të kemi problem edhe në fuqinë absorbuese të kreditimit, që besoj se është një temë tjetër, që ndoshta edhe USAID-i dhe të tjerët mund të na ndihmojnë edhe më shumë, por që realisht si ligj, besoj se ka defekte goxha serioze, të cilat bashkërisht atë që u shpjegua këtu, u shpjeguan detajet të cilat duhet të reflektohen në ligj, jo të mbeten për tu nënkuptuar, sepse ligji që nënkuptohet s’është ligj atëherë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Zotëri Betrit Balia nga Shoqata e Bankave.

PETRIT BALIA: Përshëndetje të gjithëve!
Faleminderit, i nderuar kryetar i komisionit!

Anëtarë të komisionit,
Përfaqësues të USAID-it,
Pjesëmarrës dhe medie,

Si institucione financiare pajtohemi në këtë rast, që kjo është një zhvillim shumë pozitiv, për dallim nga shumë tema që janë kontroversiale, ndoshta. Për aktorët e ndryshëm në treg, mendoj që kjo është një zhvillim shumë pozitiv për të gjithë dhe në parim të gjithë pajtohemi që do ta çojë ekonominë e Kosovës, sadopak, përpara.

Ne si industri bankare nuk kemi ndonjë risk të drejtpërdrejtë nga zhvillimi i këtij fondi dhe të gjitha sugjerimet tona dhe komentet shkojnë në funksion të participimit sa më të madh të bankave në këtë fond. Domethënë, sugjerimet që do t'i japim në vijim janë jo që paraqesin ndonjë risk për sektorin, por thjesht për ta përmirësuar këtë ligj, në mënyrë që fondi të shfrytëzohet sa më shumë nga bankat dhe participimi të jetë sa më i madh dhe bizneset të kenë sa më shumë qasje në kreditim.

Sipas parashikimeve preliminare, që janë bërë nga bankat, parashihet që në aspektin afatshkurtër do të krijohet një portofol kreditor rreth 20 milionë euro, ndërsa në aspektin afatgjatë diku rreth 300 milionë euro, që paraqet një portofol kreditor shumë serioz, që është i krahasueshëm me një bankë të madhe në raport me sektorin bankar të Kosovës. Prandaj, mendojmë që qeverisja e këtij institucioni është shumë me rëndësi duke pasur parasysh edhe fuqinë që do ta ketë ky fond në të ardhmen në sektorin financiar dhe në financimin e bizneseve.

Në lidhje me qeverisjen, fillimisht më lejoni vetëm të them, se kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me USAID-in deri më tani, kemi pasur konsultime të shumta gjatë pothuajse dy viteve të kaluara dhe jemi mjaft të kënaqur me bashkëpunimin me USAID-in. Megjithatë, ka gjithmonë hapësirë për komente dhe sugjerime.

Sa i përket qeverisjes së këtij fondi, mendojmë se duhet të jetë pak më e qartë, siç tha edhe zoti Beqaj, që duhet të kemi më tepër qartësi se si duhet të qeveriset ky institucion, si duhet të jetë mbikëqyrja e këtij institucioni. Sigurisht, që ligji specifikon se bordi do të jetë ai që do ta mbikëqyrë dhe shumicën e vendimeve do t'i merr bordi i fondit, por megjithatë kriteret mbi të cilat do të merren këto vendime janë pak të paqarta. Në veçanti, me përcaktimin e tarifave të participimit për institucionet financiare.

Mendojmë që për të marrë pjesë sa më shumë bankat, kjo tarifë për participim duhet të jetë sa më e ulët, sepse tarifa e participimit reflekton në koston e kredisë dhe në normën e interesit, me të cilën do të jepet kjo kredi. Prandaj, në pjesën e ligjit ku thuhet që tarifa do të përcaktohet në bazë të nevojës për kostot operative të fondit, aty duhet të ketë një mekanizëm të transparencës së funksionimit të këtij fondi, në mënyrë që vërtetë tarifën të jenë të arsyeshme dhe operimet, ose shpenzimet operative të fondit të jenë të arsyeshme, në mënyrë që edhe tarifa të jetë më e ulët e pastaj kredia të jetë më e ulët, norma e interesit për kredi të jetë më e ulët për biznesin.

Gjithashtu mendojmë që peshimi i riskut të këtij ekspozimi të bankave duhet të jetë sa më i ulët, për shkak se sa më i ulët që është peshimi i riskut, aq më shumë do të jenë të interesuara institucionet financiare për të marrë pjesë në këtë. Këtu duhet të përfshihet edhe Banka Qendrore

e Kosovës në këtë diskutim rreth peshimit të riskut të këtij ekspozimi, sepse bankat gjithmonë e shohin si një temë shumë të rëndësishme peshimin e riskut.

Në anën tjetër, kemi një shpresë që kjo do të ndikojë pozitivisht në uljen e normave të interesit dhe ofrimin në qasje sa më të madhe të bizneseve në kreditim, sidomos të mikrobizneseve. U përmend këtu, që një problematikë e madhe është zbatimi i kontratave në Kosovë, pasi që jemi në vendin e 138-të, por është interesante që në anën tjetër jemi në vendin e 23-të për qasje në kredi. Do të thotë, edhe pse kemi rënë nga vendi i 19-të në të 23-in, ende qëndrojmë mirë për qasje në kredi, në krahasim me zbatimin e kontratave ku jemi në vendin e 138-të.

Për ta ruajtur këtë pozitë dhe për të mos shkuar më tutje në rënie të qasjes në kredi, besoj që duhet të adresohet, siç tha edhe kryetari i komisionit, çështja e zbatimit të kontratave pak më me urgjencë dhe më prioritet.

Riimbursimi prej 50% i fondit mendojmë që është i mjaftueshëm si përqindje dhe e krijon një ndjenjë më të sigurt te institucionet financiare për të lëshuar kredi për këto biznese, të cilat mund të mos kenë kolateralin e nevojshëm apo mos të përmbushin kriteret e zakonshme, ose standarde. Megjithatë, bankat janë zotuar që ato do të ndjekin praktika të zakonshme, sa i përket aprovimit të kredive. Pra, nuk do të paramendojmë se kemi këtu një fond të granteve, por kemi të bëjmë me kredi prapëseprapë, dhe kriteret do të jenë mjaft strikte, përveç në rastet kur është fjala për kolateral, gjë që e adreson vet fondi garantues. Kjo do të krijonte edhe një siguri të mirë për fondin, në mënyrë që të mos ketë kërkesa të shumta për riimbursim.

Në bazë të përvojave të mëhershme me këtë lloj instrumentesh financiare dhe fondesh, ne kemi parë që nuk ka edhe shumë probleme sa i përket kthimit të kredive. Normat e kredive joperformuese në këto lloje të fondeve kanë qenë gjithmonë të ulëta dhe mendojmë të vazhdojmë me këtë lloj praktike dhe vigjilence, sa i përket lëshimit të kredive dhe aprovimit të kredive.

Megjithatë, është një pikë në ligj e cila i lejon bordit të fondit që të vendos se kur duhet të riimburohet një institucion financiar për 50%-shin në rastet e humbjeve, që mendojmë se është pak diskrecion shumë i gjerë në ligj dhe nuk është i specifikuar mirë dhe nuk duhet t'i lehet bordit në diskrecion të plotë se kur duhet ta riimburojë një institucion financiar, pasi që mund të çojë deri te ndonjë problem në institucione financiare, ku bordi vendos të mos riimburojë institucionin. Pra, kjo krijon pak pasiguri te institucionet financiare për pjesëmarrje në këtë fond.

Do të ishte mirë që të specifikohen ato kriteret dhe pastaj bordi vendos në bazë të këtyre kritereve, sa më specifike që janë.

Këto janë disa prej sugjerimeve tona, por megjithatë, unë thash që të gjitha bankat kanë shprehur interesim dhe vullnet për të marrë pjesë në këtë fond dhe besojmë, që do të ndihmojë edhe likuiditetin e tepërt të bankave, që e kanë tash, që të plasohet në treg dhe do të thotë, është një zhvillim që të gjithë mund të përfitojnë prej kësaj, përderisa ligji adreson këto mangësi të vogla që janë, të cilat do të siguronin një stabilitet të këtij fondi në të ardhmen dhe një qeverisje të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Balia!

Tash do ta ketë fjalën kolegu... *(Ndërpreje e shkurtër e incizimit.)*... dëshirë ta kishim fjalën paraprakisht, kishim pasur dëshirë që të kemi mendime edhe nga bizneset. Ne i kemi thirrur, sa e di unë, të gjitha odat, të gjitha bizneset. Këtu po shoh që ka ardhur vetëm AKB-ja, nuk i kemi odat ekonomike të tjera, fatkeqësisht, por i kemi disa biznese që janë dy tri biznese, MONTING-u, EKO-TRADE, kemi pastaj institute si NDI, KDI, INDEP dhe ndoshta do të kishim pasur dëshirë, që në vazhdim të shohim reflektimin e tyre, a kanë ata ndonjë problem me këtë ligj apo a kanë sugjerime.

Zoti Grainca e ka fjalën.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritës të gjithë të pranishmit!

Ne si deputet kemi pasur mundësi që edhe më herët të japim komentet dhe vërejtjet tona, mirëpo nga një... sa herë që lexon ligjin, gjithmonë ke mundësi dhe të jepet rasti për të thënë diçka që mendon se do të jetë më mirë.

Unë kam disa propozime, sugjerime apo komente, si të duash t'i quajmë, për shembull, te neni 8 ku flasim për tarifat dhe provizionet, thuhet në një paragraf, se përqindja e tarifës së garancisë përcaktohet me marrëveshjen e garancisë. Nuk specifikohet në marrëveshjen e garancisë në mes cilës palë dhe a nënkupton kjo, se nga rasti në rast mund të kemi marrëveshje të ndryshme, varësisht nga shkalla e rrezikut. Me një institucion financiar të kemi në një përqindje të tarifës më të lartë e në institucionin tjetër përqindje më të ulët të tarifës. Do të thotë, duhet të specifikohet qartë, se në cilat raste dhe a kemi një marrëveshje të garancisë, që është unike..... do të thotë, që vlejnë për të gjithë fondin dhe për të gjitha institucionet financiare jo prej rasti në rast.

Te neni 9, mua më vjen mirë që një sugjerim e propozim ia kam dhënë ministres gjatë diskutimeve për futjen e mundësisë që ky fond të ofrojë edhe shërbime por edhe instrumente tjera, është futur në këtë, mirëpo më vonë do e shohim se kjo është e limituar, do të thotë për një periudhë pas 24 muajsh, që do të thotë se është një periudhë shumë e gjatë që i duhen 2 vite këtij fondi për të marrë veten dhe vetëm pas 2 viteve të fillojë me instrumente të tjera dhe unë mendoj se duhet të limitohet në 1 vit maksimumi, sepse kështu kemi mundësi t'i rrisim të hyrat e fondit.

Po ashtu, kur flasim për anëtarët e Bordit, për kriteret që duhet t'i kenë qoftë stafi qoftë anëtarët e bordit për të zgjedhur, thuhet që nuk duhet të kenë pasur marrëdhënie kontraktuale apo të kenë punuar në institucione financiare në 12 muaj të fundit.

Unë mendoj se kjo duhet të hiqet, sepse nëse kërkojmë një staf dhe një ekip menaxhues, që do të rezultojë me performancë të lartë, atëherë nëse dikush ka qenë jashtë rrjedhave financiare e bankare për 12 muaj dhe pas 12 muajve provon të kthehet, unë mendoj se atij i duhen edhe 6 muaj tjerë për të hyrë në sistem të rrjedhave dhe të punës, prandaj nuk do të duhej limituar kjo që dikush të mos ketë eksperiencë bankare në 12 muajt e fundit. Përkundrazi, do të duhej të ishte që të ketë eksperiencë bankare sepse i ndihmon performancës.

Dhe së fundi, tek investime te kapitalit të fondit, thuhet se mund të investojë në depozita, në letra me vlerë, e tjera, e tjera që kjo me automatizëm ngërthen në kundërshtim me nenin 9 i cili le limiton për 2 vitet e ardhshme. Do të thotë, ose duhet të thuhet edhe te neni 22 se fondi mund të investojë kapitalin vetëm pas 2 viteve, ose duhet të hiqet paragrafi që është te neni 9, që limiton për 24 muaj të ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Demi!

AGRON DEMI: Ndoshta po përsëritëm, por i kam vetëm tri, më shumë vërejtje të shkurtra. Njëra është se po duket që ka nevojë për plotësime, apo shpresoj se do të plotësohet në ligj, e jo në akte nënligjore, për shkak se e kemi krijuar një ambient ligjor ku më shumë ka akte nënligjore se sa ligje dhe materia që rregullohet me akte nënligjore është shumë më e madhe.

Ne e kemi bërë një hulumtim, dhe del se për çdo ligj janë 4.5 akte nënligjore, që është shumë. Por shpresoj që krejt këto që u thanë sot, do të përfshihen në ligj dhe ligji ka nevojë për akte nënligjore, por mos të mbetet materia kryesore të rregullohet me akte nënligjore.

Tjetra, jemi duke krijuar shumë fonde. Një herë s'kemi pasur asnjë, e tash kemi bërë goxha si shumë, është Fondi për eficiencën e energjisë, është ligji për eko-fondin, është ky fond, është plani për fondin për punësim dhe investime dhe kishte me qenë një sugjerim i imi që ta kenë të gjitha një qëllim të përbashkët, ose të përfshihen me një megafon i cili ka aspekte të ndryshme, por mos të mbeten kështu të çkapërderdhët.

Dhe, e fundit, ne kur e kemi pasur edhe debatin me ministren e MTI dhe gjatë diskutimit kryesor gjithmonë na është referuar, për pyetjet që i kemi bërë, me shkua dhe me e pyetur USAID-in dhe po e shoh se e njëjta gjë po përsëritet këtu.

E di që USAID-i ka ekspertizë, dhe mund të japë ekspertizë, por kjo do të duhej të ishte materie dhe projekt i Ministrisë, për shkak se implementimi i saj do të varet prej kapaciteteve të Ministrisë andaj po shpresoj se kjo do të merret në pronësi të Ministrisë, ashtu sikur që i takon, por jo tërë kohën me shkua te zoti Gold, të cilin e respektoj për ekspertizën, por po shpresoj se Ministria e Tregtisë do ta mbrojë këtë tash e tutje. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni ju!

NJOMZA ZEJNULLAHU: Faleminderit shumë për të gjitha komentet, janë të gjitha më se të mirëseardhura. Na jemi më së vetëdijshtëm që kur hartohet një ligj, pavarësisht sa mundohemi të jemi gjithëpërfshirës, me i paraparë të gjitha situatat, gjithmonë ka hapësirë për përmirësime.

Më duhet të potencoj patjetër se Ligji ka kaluar një proces gjatë konsultimit publik. Janë konsultuar odat, janë konsultuar bankat, janë konsultuar ministrinë përkatëse, kështu që pas të gjitha atyre konsultimeve kemi ardhur në këtë draft.

Është mirë të dihet se ka pasur një proces shumë të gjerë të konsultimit publik, qoftë në fazën e konceptit të dokumentit, qoftë në fazën e Projektligjit.

Shkurt, të gjitha vërejtjet janë shumë me vend, vetëm i mbetëm borxh dy çështjeve që janë shumë me rëndësi, që i ngriti pak më herët zotëri Demi, që janë të domosdoshme të specifikohen. Ishte rekomandimi i GAP-it që të shkohet me një ristrukturim dhe të involvohet sektori privat, respektivisht bankat komerciale e tjera.

Ky projekt, respektivisht kjo ide e ndërtimit të fondit të tillë, ka ardhur pas një hulumtimi shumë të gjatë – më shumë se një vit. Dhe projekti, duke e përfshirë edhe Ministrinë e Tregtisë sepse gjatë gjithë kohës kanë qenë bashkë me neve si ekip, ne jemi mbështetës të tyre, nuk jemi aktorët kryesorë, si në të gjitha projektet tjera. Pra, gjatë gjithë procesit kemi pasur konsultime dhe asnjë bankë nuk e ka shprehur interesimin me hy si aksionare. Do të thotë, fillimisht ka qenë ideja të hyhet në formën që e propozuat ju, megjithatë asnjë bankë, me përjashtim të një banke të vogël lokale që ka shprehur interesim në parim, por pa dhënë detaje, se përndryshe, të gjitha bankat tjera që kanë më shumë potencial për të participuar dhe dhënë kontribut në këtë fond, kanë qenë strikte: Jo nuk duam të marrim pjesë sepse s'duam të krijojmë obligime fituese, karshi një institucioni të tillë. Kjo ishte e para.

Dhe e dyta, sa i përket komunikimit BQK, Fond, MTI, është absolutisht esenciale, se më herët e tha edhe kryetari dhe zoti Demi, që sukcesi i këtij fondi do të varet prej bashkëpunimit me institucionet tjera sepse si i vetëm s'mund të funksionojë. Pra, me Bankën Qendrore, parashihet në ligj mënyra e raportimit, cilat raporte do të dërgohen dhe përveç kësaj është draftuar një memorandum mirëkuptimi edhe me Bankën Qendrore, që aktualisht është në rishikim te Banka Qendrore dhe deri sa ata ta pranojnë draftin dhe të pajtohen nëse të ndryshojnë diçka, që do të specifikojë detajisht në çfarë bazash, përveç që i parashihet ligji në baza të përgjithshme, memorandumit me BQK do ta detajizojë se cilat raporte i kërkon BQK nga ne, por të gjitha ato parashihen edhe në ligj. E njëjta gjë do të bëhet edhe me Ministrinë e Tregtisë.

Kemi pasur bashkëpunim deri tash, gjatë gjithë procesit të hartimit të ligjit, konsultimit publik dhe gjatë gjithë atyre edhe si i tillë do të vazhdojë.

Sa i përket vërejtjeve që u dhanë, edhe një herë falënderoj për të gjitha, të gjitha janë shumë të mirëseardhura sepse edhe neve na bëjnë t'i shohim gjërat pak më ndryshe, jashtë kontekstit në të cilin ne kemi punuar, kështu që propozojmë që të gjitha këto meqë i kemi marrë shënimet, edhe t'i trajtojmë në grup punues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zonja Hajdari!

REMZIJË HAJDARI: Faleminderit të gjithëve për komentet dhe sugjerimet që i dhanë në këtë debat. Është shumë e vërtetë që ky Projektligj është hartuar me mbështetje të USAID-it – pra projektit të USAID-it mirëpo pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatimin e këtij ligji do ta bëjë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me kapacitetet dhe burimet njerëzore që i ka.

Është Grupi punues i Kuvendit, të cilin veç e paskeni caktuar kryetar, dhe Ministria do të jetë pjesë e këtij Grupi. Vërejtjet që u dhanë, komentet që u dhanë do t'i marrim parasysh, do t'i analizojmë dhe ato që janë të mirëseardhura dhe janë të mira për këtë ligj, ne sigurisht se do t'i përkrahim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Ju tash e keni dërguar draftin në Kuvend dhe tash ky draft është vetëm në dorë të Kuvendit dhe Kuvendi ka autorizime me bë ndryshime. Ne natyrisht që do t'ju konsultojmë për mendimin tuaj, por deputetët do të vendosin lidhur me këtë.

REMZIJE HAJDARI: Po kryetar, sigurisht! Mirëpo ne jemi munduar të bëjmë një draft...

KRYETARI: Në rregull, sigurisht se para çdo amendamenti do të marrim mendimet edhe të tjerëve, por vetëm Kuvendi mund të vendosë për këtë. Kështu që mos të bëheni merak, se i pashë disa shqetësime, por ligji është në duar të mira dhe natyrisht se ne e mirëpresim përvojën e zotit Gold që e ka një përvojë shumë të gjerë dhe e falënderojmë për kontributin e dhënë edhe në këtë ligj po edhe në shumë çështje tjera në fushën e financave. Ne mirëpresim bashkëpunimin, do të kërkojmë sqarime kur t'i aprovojmë vendimet, por të jenë të sigurt se amendamentet do të jenë pronësi e Kuvendit. Kjo është nën një.

Nën dy. Mendoj se kishim një debat të mirë, meqë s'po shoh tjerë për të debatuar. Besoj se disa çështje do t'i specifikojmë. Është mirë t'i specifikojmë dhe edhe unë pajtohem që nuk është mirë të shkohet në një skaj që të rregullohen të gjitha sendet me ligj, sepse ato nesër mund të bëhen pengesë, por nën dy, nuk është mirë edhe të lihen shumë gjerë, të parregulluar, sepse atëherë ligji në zbatim mund ta humb fokusin.

Pra, ne besojmë se gjendet aty një masë të duhur dhe unë mendoj se në përgjithësi Komisioni e ka vlerësuar shumë pozitivisht përmbajtjen e ligjit dhe natyrisht që ne i kemi disa çështje për amendamentim. Do të shohim edhe nga deputetët çfarë amendamentesh kanë dërguar, do të marrim parasysh edhe transkriptin e kësaj mbledhjeje dhe do të formulojmë amendamente përkatëse me Grupin punues dhe do t'i debatojmë në Komision dhe do t'i çojmë në Kuvend sa më shpejt sepse konsiderojmë se është e rëndësishme aprovimi i këtij ligji pikërisht që të rrisim vëllimin e aktivitetit investues nga sektori privat.

Pra, ne e mirëpresim këtë, dhe falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në krijimin e këtij ligji, draftit të këtij ligji dhe gjithashtu inkurajojmë edhe Ministrinë që të vazhdojë menjëherë të krijojë akte përcjellëse dhe t'i ndërtojë kapacitetet. Sigurisht se na duhet të ndërtojë kapacitete gjithmonë për zbatim të ligjeve sepse problemi në Kosovë është më shumë te zbatimi i ligjeve se te mungesa e ligjeve.

Kjo është esenciale dhe sa më shpejt që këtë ta vëmë në theks, më mirë do t'i kemi punët.

Çështja tjetër, që ka të bëjë me aktivitetin kreditor, që e përmendi zoti Balia. Ne kemi një situatë, një rënie të interesave dhe sigurisht tregu e ka bërë të veten, apo edhe lodhja e bizneseve me kredi dhe tash ata nuk kanë fuqi as me marrë kredi, sepse janë të ngarkuar me kredi. Ne jemi të lumtur që kemi pak kredi të këqija dhe këtu Kosova tregon se vërtet bizneset tona janë të përgjegjshëm, shumë më të përgjegjshëm se sa mjedisi afarist dhe tjerët që i zbatojnë ligjet, dhe kjo është rrethanë shumë e mirë edhe për këtë fond që kemi pak kredi të këqija. Pra, më së paku gati në rajon.

Mirëpo, nuk kisha dashur që bankat të jenë shumë të vetëkënaqura me aktivitetin e tyre kreditor, sidomos në prodhim dhe sidomos në eksport.

Dhe vetë fakti që ne e kemi një normë shumë të madhe të fitimit, gjë që s'është keq, por në qoftë se bankat fitojnë, e bizneset janë të lodhura. Ne e kemi një kontradiktë këtu që duhet ta hulumtojmë dhe analizojmë. Pra, prej nga po vjen kjo?

Ne jemi të lumtur që bankat janë solide, stabile, por në qoftë se bizneset janë të lodhura dhe nuk kanë ndonjë aktivitet të duhur investues, atëherë është ky problem për shoqërinë, jo për banka. Ky është problem për BQK-në, ky është problem për Qeverinë, ky është problem për Kuvendin dhe duhet të analizohet.

Mirëpo, edhe bankat, nëse nisen nga përgjegjësia sociale e korporatave duhet të shohin klientët e vet si janë duke jetuar.

Ju faleminderit, dhe punë të mbarë për më tutje!